



BASHKIA  
TIRANË

**URDHËR**

Nr. 22382 datë 06.06 2017

**“PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE VENDET E AFISHIMIT TË TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b) dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; nenit 24, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar; ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” i ndryshuar; udhëzimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 1, datë 30.05.2017 “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

**URDHËROJ:**

1. Pranë zyrave dhe ambienteve të çdo Njësie Administrative të Bashkisë Tiranë, kryhet afishimi i materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor.
2. Në vendet e afishimit të përcaktuara sipas pikës 1, subjektet zgjedhore lejohen të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.
3. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.
4. Pas marrjes së informacionit nga subjektet zgjedhore për adresat e sakta të zyrave elektorale, brenda 5 ditëve të bëhet verifikimi i vendndodhjes së tyre dhe respektimi i dispozitave të udhëzimit nr. 1, datë 30.05.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për afishimin dhe vendosjen e materialeve propagandistike.
5. Policia Bashkiake merr masa të menjëhershme për heqjen e materialeve propagandistike të afishuara dhe të vendosura në kundërshtim me këtë urdhër dhe kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe Policia Bashkiake për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion VELIAJ

